

# KUJDES!

- Mos harroni të kodoni grupin (A ose B) në fletë-përgjigjen e provimit. **Fletë-përgjigjet me grupin e pakoduar nuk vlerësohen.**
- Çdo pyetje ka vetëm një përgjigje të saktë. Nëse një pyetjeje i jepni dy përgjigje atëherë ajo pyetje do të vlerësohet si e gabuar.
- Përgjigja do të kodohet me laps. Në të kundërt kompjuteri nuk do ta lexojë.
- Përgjigjen e pyetjes do ta kodoni vetëm brenda rrethit siç është vepruar në shembullin e poshtëshënuar

Saktë  A  B  C  D

Gabim  A  B  C  D

- Bëni kujdes për të mos dalë jashtë rrethit kur të kodoni përgjigjen.
- Mos bëni asnjë veprim mbi fletë përgjigjen e provimit si shkarravitje, rrudhosje etj.
- Mos iu përgjigjini pyetjeve për të cilat nuk jeni të sigurtë. **Kujdes! 3 përgjigje gabim fshijnë një të saktë.**
- Mos qëndroni shumë tek pyetjet që nuk zgjidhni dot, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për t'iu përgjigjur pyetjeve të tjera.
- Koha e provimit është **100 minuta**. Shfrytëzoni deri në fund kohën e provimit. Në qoftë se ju tepron kohë, bëjini dhe një kontroll testit.
- Përgjigjet e pyetjeve që ndodhen në këtë libërth, do të kodohen në fletë-përgjigje në pjesën ku shkruan “PERGJIGJET”.
- Në provim **ndalohet** mbajtja ose përdorimi i celularit dhe makinës llogaritëse.
- Rezultati i provimit bazohet vetëm në fletë-përgjigje.
- Libërthi i pyetjeve dorëzohet bashkë me fletë-përgjigjen dhe nuk kërkohet marrja e tij.

*Suksese!*

**1.**

Sa është diferenca midis shumëfishit më të vogël të përbashkët dhe faktorit më të madh të përbashkët të numrave 18 dhe 42?

- A) 126                      B) 124  
C) 122                      D) 120

**2.**

Gjeni rezultatin e  $\sqrt{64} - \sqrt[3]{64}$ .

- A) 2                          B) 4  
C) -4                        D) -2

**3.**

Cila është kufiza e 7 për vargun me rregull  $5n - 3$ ?

- A) 38                        B) 35  
C) 32                        D) 29

**4.**

Trefishi i një numri i zbritur me 5 është 22. Sa është ai numër?

- A) 9                          B) 11  
C) 13                        D) 15

5.

Është dhënë formula  $a = \frac{v^2}{r}$ .

Gjeni a-në nëse  $v = 6$  dhe  $r = 9$ .

- A) 2                      B) 4  
C) 6                      D) 8

6.

Numri 8.9993 i rumbullakosur me 2 shifra pas presjes dhjetore është:

- A) 8,99                      B) 9,1  
C) 9,00                      D) 8,9


7.

Cili nga pohimet është i saktë?

- A)  $2.8 \text{ m} > 270 \text{ cm} > 3100 \text{ mm}$   
B)  $46 \text{ cm} > 4.2 \text{ m} > 410 \text{ mm}$   
C)  $35 \text{ mm} < 28 \text{ cm} < 0.6 \text{ m}$   
D)  $0.7 \text{ km} < 800 \text{ cm} < 200 \text{ mm}$

8.

Nëse ABCD është paralelogram gjeni këndin  $\widehat{AOD}$ .



- A) 60°                      B) 63°  
C) 66°                      D) 69°

**9.**

Cila është mesorja e numrave  
58, 49, 51, 44, 49, 54, 47, 52?

- A) 49                                      B) 52  
C) 44                                      D) 50

**10.**

Sa është një e pesta e dy të tretës?

- A)  $\frac{3}{10}$                                       B)  $\frac{2}{15}$   
C)  $\frac{10}{3}$                                       D)  $\frac{15}{2}$

**11.**

Besniku ka  $2\frac{1}{2}$  kg luleshtrydhe, ndërsa

Artani ka  $1\frac{1}{4}$  kg më shumë se Besniku.

Sa kilogram luleshtrydhe kanë të dy së bashku?

- A)  $1\frac{1}{4}$  kg                                      B)  $\frac{3}{4}$  kg  
C)  $3\frac{3}{4}$  kg                                      D)  $6\frac{1}{4}$  kg

**12.**

Sipërfaqja e një rrethi është  $25 \text{ cm}^2$ . Rrezja është afërsisht:

- A) 1,8cm                                      B) 2,8cm  
C) 3,2cm                                      D) 5,6cm


**13.**

Një rrotë biçiklete ka një diametër prej 70cm. Afërsisht sa rrotullime do të bëjë kjo biçikletë në rast se përshkon një rrugë 1,1km të gjatë?

- A) 50                      B) 250  
C) 500                     D) 80

**14.**


Gjeni brinjën x që mungon në figurë.



- A) 19 cm                      B) 4,75 cm  
C) 6,5 cm                     D) 12 cm

**15.**

Jepet hapja e një figure gjeometrike si më poshtë:




Gjeni emrin e kësaj figure si dhe sipërfaqen e përgjithshme të saj.

- A) Kubiod -  $2,04\text{ m}^2$   
B) Piramid -  $204\text{ cm}^2$   
C) Prizëm trekëndore -  $204\text{ cm}^2$   
D) Prizëm trekëndore -  $2,04\text{ m}^2$

**16.**

Perimetri i trekëndëshit të mëposhtëm është 30 cm. Gjeni brinjën më të shkurtër.



- A) 3cm                      B) 6cm  
C) 10cm                    D) 14cm

**17.**

Cili nga ekuacionet e mëposhtme tregon që shumta e dy numrave të njëpasnjëshëm është 35?

- A)  $n + 2n = 35$                       B)  $2n + 1 = 35$   
C)  $n + 1 = 35$                         D)  $n + 2 = 35$

**18.**

Mesatarja aritmetike e 5 numrave është 9. Nëse katër numrat e parë janë: **7, 8, 10 dhe 12** atëherë cili është numri i pestë?

- A) 7                                      B) 8  
C) 10                                     D) 12

**19.**

Sa është 8% i 50\$?

- A) 1,60\$                                B) 4,00\$  
C) 6,25\$                                D) 40\$

**20.**

Sajmiri e ka shkollën 4km larg shtëpisë. Nëse ai ka ecur 500m, edhe sa përqind e rrugës i mbetet për të bërë?

- A) 12,5%                                B) 87,25%  
C) 87,5%                                D) 8%

**21.**

Cila nga koordinatat e mëposhtme nuk bën pjesë në drejtëzën  $y = 3x + 5$ ?

- A) (-1, 2)                                B) (4, 17)  
C) (-2, 11)                               D) (0, 5)


**22.**

Cila është mënyra më e thjeshtë e raportit **240ml : 4l**.

- A) 240 : 4                                B) 3 : 50  
C) 60 : 1                                 D) 12 : 200

23.

Eduarti udhëtoi 80km me makinë nga shtëpia e tij. Rrugës ai ndalon për të takuar shoqen e tij Elda. Më poshtë është dhënë dhe grafiku Distancë-Kohë.



Sipas grafikut per sa kohë ka qendruar Eduarti me Eldën

- A) 2 orë e 30 min
- B) 1 orë e 30 min
- C) 3 orë
- D) 2 orë 45 min


24.

Nëse do të ndajmë 4800 lekë në raportin  $3 : 7 : 10$ , atëherë sa lekë i takojnë personit që ka pjesën më të vogël të lekëve?

- A) 240 lekë
- B) 720 lekë
- C) 830 lekë
- D) 560 lekë

25.

Jepet denduria e grupmoshave në grafikun e mëposhtëm:



Sa është probabiliteti që një person i zgjedhur rastësisht të jetë në grupmoshën 59 – 62?

- A)  $\frac{1}{2}$
- B)  $\frac{2}{5}$
- C)  $\frac{1}{5}$
- D)  $\frac{1}{4}$


**26.**

Albani hedh një zar. Sa është probabiliteti që zari të bjerë numër i thjeshtë (prim)?

- A)  $\frac{2}{3}$                       B)  $\frac{1}{2}$   
 C)  $\frac{1}{3}$                       D)  $\frac{4}{6}$

**27.**

Sa centimetra është perimetri i figurës së mëposhtme?



- A) 18 cm                      B) 22 cm  
 C) 26 cm                      D) 24 cm


**28.**

Sipërfaqja e një katrori është  $64\text{cm}^2$ . Sa është njëra brinjë?

- A) 6 cm                      B) 7 cm  
 C) 8 cm                      D) 32 cm

**29.**

Figura e mëposhtme është e përbërë nga kuba të vegjël me brinjë 1cm secili.



Sa është vëllimi i kësaj figure?

- A)  $24\text{ cm}^3$                       B)  $18\text{ cm}^3$   
 C)  $12\text{ cm}^3$                       D)  $9\text{ cm}^3$

**30.**

Sa është mesorja sipas të dhënave në tabelë?


Numri Këpucës	Denduria
40	6
41	8
42	10
43	12

- A) 40                      B) 41  
 C) 42                      D) 43



**31.**


Sa rathë janë gjithsej në figurë?



- A) 12
- B) 13
- C) 14
- D) 15


**32.**

Cili numër duhet të jetë në vend të pikëpyetjes?



- A) 37
- B) 45
- C) 53
- D) 61



**33.**



Cila figurë vijon?

- A)
- B)
- C)
- D)

**34.**



Cila figurë vijon?

- A)
- B)
- C)
- D)

**35.**

Cila është kufiza pasardhëse në vargun e mëposhtëm?

7, 8, 9, 10, 12, 14, 16, 18, 22, 26, ?

- A) 28
- B) 30
- C) 32
- D) 34

**36.**

Cili numër duhet të jetë në vend të pikëpyetjes?

8		7		9		6
	68				78	
6		2		8		3

10		9
	?	
2		2

- A) 38
- B) 72
- C) 86
- D) 94

**37.**

Cili numër duhet të jetë në vend të pikëpyetjes?

63 → 369

47 → 7411

86 → ?

A) 1468


B) 6814

C) 6886

D) 6841

**38.**

Cila figurë është e veçantë nga të tjerat?




A) A

B) B


C) C

D) D


**39.**



Cila figurë vijon?



**40.**



Cila figurë vijon?

A)            B)            C)            D)



**41.**

Cili numër duhet në vend të X.

64	8	2	6
21	7	1	2
30	5	1	5
24	4	2	X


A) 4                                  B) 3  
C) 2                                  D) 1

**42.**


Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?  
1, 14, 2, 10, 3, 6, 4, ?

A) 1                                  B) 2  
C) 3                                  D) 4

**43.**




Cila figurë vijon?



**44.**

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) 11
- B) 13
- C) 15
- D) 23


**45.**

Cila kufizë duhet në vend të pikëpyetjes?


1, 4, 8, 13, 19, ?


- A) 24
- B) 25
- C) 26
- D) 27


**46.**




Cila nga figurat është më e ngjashme me figurën e mësipërme?

A) 




B) 

C) 

D) 

**47.**

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?




- A) 2
- C) 6


- B) 4
- D) 8

**48.**


Cila është pjesa që mungon?




A)




B)




C)




D)




49.




Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?



50.



Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?



51.

Autori i novelës *“Kush e solli Doruntinën”* është:

- A) Populli
- B) Ismail Kadare
- C) Dritëro Agolli
- D) Mitrush Kuteli

52.

Personazhi i Uliksit i përket fragmentit:

- A) “Arnaut Osmani”
- B) “Kthimi i Odisesë”
- C) “Martesa me Orën-zonjë”
- D) “Pyetja e fundit”

53.

Simbolikën e Perlës së Detit e gjejmë në fragmentin letrar:

- A) “Një kryqëzim”
- B) “Kolombreja”
- C) “Djemtë e Rrugës Pal”
- D) “Nata e Ustikës”

54.

Fragmenti: *“...Kam një kafshë shumë të veçantë, gjysmë kotele dhe gjysmë qengj...”*, është shkëputur nga pjesa:

- A) “Një kryqëzim”
- B) “Kolombreja”
- C) “Lumi i madh”
- D) “Nata e Ustikës”

55.

*“Lumi qeshte nën mustaqe”*, kemi figurën letrare të:

- A) krahasimit
- B) epitetit
- C) antitezës
- D) metaforës

56.

Karakteristikë e rrëfimit të Kutelit tek pjesa *“Lumi i madh”* është se:

- A) Nuk përdoren mjete stilistikore për të transmetuar efekte artistike.
- B) Personazhet përdorin një ligjërim të nivelit të lartë.
- C) Flitet në vetën e parë shumës.
- D) Autori rrëfen sikur ka përpara një bashkëbisedues.



57.

Personazhet e *Andreas, Bozhos, Sonjës dhe Kadriut*, i gjejmë në fragmentin letrar:

- A) “Kolombreja”
- B) “Një kryqëzim”
- C) “Nata e Ustikës”
- D) “Siç më thotë nënua plakë”

58.

Është shkruar në formën e sonetit poezia:

- A) “Lule dielli” D. Agolli
- B) “Fytyra e saj” Z. Serembe
- C) “Vdekja e Nositit” L. Poradeci
- D) “Himn Nilit”

59.

Identifikimin e unit lirik me të mirën dhe të keqen njëkohësisht, e gjejmë në poezinë:

- A) “Kinema e vjetër”
- B) “Poradeci”
- C) “Ekstazë pranverore”
- D) “Një ditë e ka dhe korbi”

60.

Vargjet; “*Duke nisur udhëtimin mes-për-mes në Shqipëri,/ Drini plak e i përrallshëm po buron prej Shëndnaumi...*”, janë:

- A) 13 dhe 14 rrokësh
- B) 15 dhe 16 rrokësh
- C) 16 dhe 17 rrokësh
- D) 17 dhe 18 rrokësh

61.

Folja “*do të ishit takuar*” është në mënyrën:

- A) dëftore, e ardhme e përparme, veta II, shumës
- B) lidhore, e kryer, veta II, shumës
- C) dëftore, më se e kryer, veta II, shumës
- D) kushtore, e kryer, veta II, shumës

62.

Dalloni në cilin rast fjala “**ndaj**” është përdorur si parafjalë:

- A) Po përpiqem të **ndaj** legjendën prej reales.
- B) Nga qoshja ku isha ulur, kisha përparësi **ndaj** të tjerëve.
- C) Kishim mbërritur në çastin e fundit, **ndaj** dhe ishim ulur në një kënd të sallës.
- D) Duhet të **ndaj** tekstet letrare nga ato joletrare.

63.

Përcaktoni alternativën ku është përdorur emri i farefisnisë:

- A) Qëndronin pranë zjarrit me të zotin e shtëpisë.
- B) U tregove i zoti në matematikë.
- C) Ti je një lojtar i zoti.
- D) Sa e mençur dhe e zonja je!

64.

Fjala **“më të çuditshme”** në fjalinë: **“Pashë ëndrrën më të çuditshme që mund të përfytyrohet.”** është:

- A) emër në rasën gjinore
- B) mbiemër në shkallën krahasore
- C) ndajfolje në shkallën krahasore
- D) shprehje parafjalore

65.

Në cilin rast **“kush”**, është përdorur si përemër lidhor:

- A) Ishte kush te dera e jashtme?
- B) Kush e mban mend atë ngjarje, të ma tregojë.
- C) Ty nuk ta ka fajin kush.
- D) Kush të foli ty?

66.

Në fjalinë: **“Të gjithë shqiptarët, gegë, toskë, kosovarë, maqedonas, janë vëllezër.”**- fjalët e nënvizuara janë:

- A) përcaktorë me drejtim
- B) përcaktorë me përshtatje
- C) përcaktorë me bashkim
- D) ndajshtim i veçuar

67.

Në fjalinë me pjesë të nënrenditur përcaktore, dalloni rastin kur paraprijësi shprehet me emër:

- A) Të gjithë që u ndodhën atje, u habitën nga ai lajm.
- B) Iu afrua tryezës, ku qe vendosur një dosje e madhe.
- C) Atë që ndodhi atë ditë, njerëzit s’do ta harrojnë kurrë.
- D) Të tërheq vëmendjen kjo, që edhe të vegjlit marrin pjesë në pastrimin e mjedisit.

**68.**

Gjendet vetëm me folje në formën veprorë:

- A) Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë
- B) Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë
- C) Kundrinori i drejtë
- D) Kundrinori i drejtë me parafjalë

**69.**

Ç'është "*që*" në fjalinë; "Zgjidha ushtrimin më të vështirë që mund të përfytyrosh.":

- A) lidhëz
- B) përemër lidhor
- C) ndajfolje lidhëzore
- D) parafjalë

**70.**

Kur folja kalon nga forma veprorë në formën joveprorë, kryefjala kthehet në:

- A) Kundrinor të zhdrejtë me parafjalë.
- B) Kundrinor të zhdrejtë pa parafjalë.
- C) Kundrinor të drejtë.
- D) Kallëzues.

